# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5524
E enjte, 12 korrik 2018
çmimi 0.40 €


## Ministri Ismaili: Furnizimi me barna është stabilizuar

FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI FAQE 4-5

# Presidenti duhet ta udhëheqë dialogun



### - Presidenti duhet të jetë udhëheqës i një delegacioni konsensual i cili autorizohet nga Kuvendi i Kosovës për të negociuar me Serbinë

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, i ka ftuar partitë politike për konsensus rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se konsensusin e parë që duhet ta arrijnë partitë është ai për vija të kuqe që Kosova duhet t'i ketë në këtë proces. Ajo ka vlerësuar se vija të kuqe duhen të jenë njohja reciproke, pakoja e Ahtisarit dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB. Tahiri ka theksuar se Kuvendi duhet ta miratojë platformën për këto bisedime dhe ta autorizojë presidentin dhe ekipin negociator i cili do ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces dialogues

## AKTUALE



PRAKTIKA E TASHME E REKOMANDIMEVE ËSHTË JOKORREKTE F. 11

Hajdin ABAZI

PRESIDENTI THAÇI URON FERMERËT PËR NISJEN E FUSHATËS SË KORRJE-SHIRJEVE TË GRURIT F. 6

NATO-ja FTON MAQEDONINË T'I NISË NEGOCIATAT E ANËTARËSIMIT F. 2

LV-ja: ÇËSHTJET KOMBËTARE NUK MARRIN ZGJIDHJE PËRFUNDIMTARE ME INTEGRIMIN NË BE F. 3

## Statuti për Asociacionin do të dorëzohet në Bruksel



Ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe ka bërë me dije se në përputhje me mandatin që i është besuar nga marrëveshjet e Brukselit, është duke punuar për hartimin e draftstatutit të këtij asociacioni. Nëpërmjet një komunikate për medie ekipi menaxhues ka paralajmëruar se statutin e Asociacionit do ta dorëzojnë në Bruksel, kurse Qeverisë do t'ia dorëzojnë një raport të punës. Ndërsa LDK-ja ka kërkuar përfshirjen e Qeverisë për hartimin e statutit të Asociacionit, duke thënë se statuti duhet të jetë vetëm sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese sepse çdo devijim është antikushtetues dhe i papranueshëm FAQE 3

## EKONOMI

LLUKA THOTË SE SITUATA NË POSTË ËSHTË SHQETËSUESE F. 8

BERAT RUKIQI ZGJEDHET KRYETAR I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS F. 9

## KULTURË

CERTIFIKOHET PËR HERË TË PARË PUNA VULLNETARE NË KOSOVË F. 9

## SPORT

SHORT I PAMËSHIRSHËM PËR SIGAL PRISHTINËN NË LIGËN E KAMPIONËVE F. 16

## Në tetor do të dihen saktë ndotësit kryesorë në Kosovë



Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka mbajtur të mërkurën takim me përfaqësuesit e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), për të diskutuar rreth fazës së parë të projektit për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit. Ajo ka theksuar se rezultatet preliminare mbi ndotësit kryesorë në Kosovë do të jenë gati në tetor të këtij viti, pas studimit të hollësishëm njëvjeçar nga ekspertët japonezë FAQE 7


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Rama shpreson në njohjen e plotë të Kosovës




**Bruksel, 11 korrik** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të mërkurën shprehu shpresën se Beogradi dhe Prishtina do të gjejnë një zgjidhje përmes dialogut, e cila do të ishte njohja e pavarësisë së Kosovës. Në deklaratën e tij për gazetarët serbë në margjinat e Samitit të NATO-s në Bruksel, Rama i shprehu mirënjohje të madhe presidentit Aleksandar Vuçiq për punën e vështirë që po bënte për të hyrë në këtë proces dhe për t'i dhënë fund zgjidhjes Takimi i vendeve anëtare të aleancës gjithashtu mbahet nën një frymë jo pozitive sa iu përket negociatave të BE-së me Britaninë për Brexit, por kryeministri Edi Rama, i cili po merr pjesë në punime, thekson se "Shqipëria vlerësohet shumë pozitivisht për kontributin e saj në programin e Aleancës". Sipas Ramës, ka vlerësim të konsiderueshëm nga aleatët edhe për "rritjen e buxhetit të mbrojtjes, pjesëmarrjen me 13 % të trupave të veta në frontet e përbashkëta, qasjen aktive kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm". "Duke vlerësuar lart marrëveshjen e arritur në mes të Athinës dhe Shkupit, Shqipëria mbështet nisjen e procedurave për anëtarësimin sa më parë në NATO të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ka shkruar Rama në një postim në "Facebook".

# NATO-ja fton Maqedoninë t'i nisë negociatat e anëtarësimit

Vendet anëtare të NATO-s në Samitin e Brukselit të mërkurën vendosën që Maqedonisë t'i bëjnë ftesë për anëtarësim në organizatë, por vendi mund të bëhet pjesë e Aleancës vetëm pasi t'i ketë zbatuar të gjitha proceset për ndryshimin e emrit, sipas marrëveshjes me Greqinë



**Bruksel, 11 korrik** - Vendet anëtare të NATO-s janë pajtuar që Maqedonisë t'i bëjnë ftesë për anëtarësim në organizatë, por vendi mund të bëhet pjesë e Aleancës vetëm pasi t'i ketë zbatuar të gjitha proceset për ndryshimin e emrit, sipas marrëveshjes me Greqinë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, duke folur pasdite në një konferencë për media në Bruksel, tha se dyert e NATO-s mbeten të hapura. Ai tha se vendet anëtare e përshëndesin marrëveshjen, të cilën e quajti historike, midis Athinës dhe Shkupit për zgjidhjen e problemit të emrit. "Sot u pajtuam që ta ftojmë Qeverinë e Shkupit t'i fillojë bisedimet për integrim. Pasi të kenë përfunduar të gjitha procedurat kombëtare për finalizimin e marrëveshjes rreth emrit, atëherë vendi do t'i bashkohet NATO-s si anëtari i tridhjetë", tha sekretari Stoltenberg duke e bërë të qartë se ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka një rast që ndodh një herë në jetë. "Qytetarët duhet të vendosin. Ose do ta zbatoni marrëveshjen dhe të hyni në NATO ose nuk do të hyni. E juaja është ta bëni zgjedhjen, por nuk mund t'i keni të dyja. Dyert e NATO-s janë të hapura. Ju duhet ta bëni zgjedhjen", tha Jens Stoltenberg, sekretar i përgjithshëm i NATO-s.

Procedura e bisedimeve paraaderuese midis Maqedonisë dhe NATO-s duhet të përfundojë brenda gjysmë viti. "Bisedimet para-qasëse midis Maqedonisë dhe NATO-s pritet të zgjasin nga 4 deri në 6 muaj. Deri në këtë periudhë Maqedonia duhet ta përmbushë në tërësi Marrëveshjen me Greqinë, në të kundërtën anëtarësimi do të dështojë", tha Stroltenberg.

Pas përfundimit të bisedimeve para-aderuese dhe pas finalizimit të tërësishëm të Marrëveshjes me Greqinë, që do të thotë mbajtjen e referendumit në vjeshtë dhe më pas ndryshimet kushtetuese, do të nisë edhe ratifikimi i protokollit para-aderues nga vendet anëtare të NATO-s. I gjithë procesi, duke filluar nga marrja e datës e deri në anëtarësimin e plotë, nuk pritet të zgjasë më shumë se 18 muaj. Maqedonia është kandidate për anëtarësim në NATO që prej 19 vjetësh, ndërsa në vitin 2008 në Samitin e Bukureshtit ishte shumë pranë marrjes së ftesës, por për shkak të vetos greke lidhur me emrin, dështoi nisja e bisedimeve para-aderuese dhe anëtarësimi në Aleancën Veriatlantike.

## Kryemadhi: LSI, jo pjesë e pazareve për ta shpëtuar Ramën




**Tiranë, 11 korrik** - Monika Kryemadhi deklaroi se LSI nuk do të ketë asnjë marrëveshje apo bisedime me mazhorancën sa i përket bashkimit të votave për votimin e ligjit të magjistraturës. Ajo theksoi se LSI-ja ka qenë dhe do të jetë pro dhe pjesë e çdo takimi apo tryeze që trajton dhe diskuton përmirësimin e jetës së shqiptarëve dhe largimin e klikës së Edi Ramës. "LSI-ja nuk do të jetë kurrë pjesë e pazareve për ta shpëtuar Edi Ramën! Asnjë marrëveshje apo bisedim nuk ka dhe nuk do të ketë për t'i zgjatur agoninë kësaj qeverie që, e zhytur në krim, trafiqe të paligjshme dhe korrupsion, po përpiqet, në grahmat e fundit, të mund të shpëtojë me manipulime të tilla. LSI ka qenë dhe do të jetë pro dhe pjesë e çdo takimi apo tryeze që trajton dhe diskuton përmirësimin e jetës së shqiptarëve dhe largimin e klikës së Edi Ramës", tha ajo.

Kryemadhi ka shtuar se çdo përpjekje tjetër për ta përfshirë LSI-në në bisedime është thjesht pjesë e fantazisë së sëmurë të Edi Ramës, që sot më shumë se kurrë është i gatshëm të blejë e të shesë çdo gjë e çdokënd në emër të pushtetit, por që duhet ta ketë më shumë se kurrë të qartë, se për ta shpëtuar karrigen e tij nuk do ta ketë kurrë ndihmën e LSI-së. "Ne do të vazhdojmë të jemi pjesë e opozitës së bashkuar, me qëllimin e qartë dhe të saktë, largimin e pushtetit banditesk të Edi Ramës! Ta shpëtosh sot Edi Ramën do të thotë të shkatërrosh përfundimisht të ardhmen e shqiptarëve. Këtë mëkat LSI-ja nuk e merr në kurriz", tha Kryemadhi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Statuti për Asociacionin do të dorëzohet në Bruksel

Ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe ka bërë me dije se në përputhje me mandatin që i është besuar nga marrëveshjet e Brukselit, është duke punuar për hartimin e draftstatutit të këtij asociacioni. Nëpërmjet një komunikate për medie ekipi menaxhues ka paralajmëruar se statutin e Asociacionit do ta dorëzojnë në Bruksel, kurse Qeverisë do t'ia dorëzojnë një raport të punës. Ndërsa LDK-ja ka kërkuar përfshirjen e Qeverisë në hartimin e statutit të Asociacionit, duke thënë se statuti duhet të jetë vetëm sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese sepse çdo devijim është antikushtetues dhe i papranueshëm




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të mërkurën nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se është duke punuar për hartimin e draftstatutit të këtij asociacioni në përputhje me mandatin që i është besuar nga marrëveshjet e Brukselit. Në këtë kontekst, ekipi menaxhues ka treguar se statuti i Asociacionit nuk i është dorëzuar Qeverisë, por do të dorëzohet në Bruksel. "Draftstatuti nuk i është dorëzuar Qeverisë në Prishtinë, siç pretendohet nga disa media, por është dërguar vetëm raporti mbi punën tonë deri më tani, dhe përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal, Qeveria është informuar rregullisht për dinamikën e aktiviteteve tona", është thënë në njoftimin e ekipit menaxhues.

Po sipas këtij njoftimi, puna e ekipit bazohet në rezultatet e dialogut të Brukselit dhe në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. "Në punën e mëparshme ne kemi pasur diskutime me një numër të grupeve profesionale të ekspertëve, përfaqësues të pushtetit lokal, si dhe ministritë përkatëse. Si një organ profesional me një mandat dhe kompetenca të përcaktuara në mënyrë të qartë, besojmë se çdo përpjekje për politizimin e aktiviteteve tona është kundërproduktive dhe dëmton procesin e dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës", është theksuar në komunikatën e ekipit menaxhues të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Ndaj kësaj situate ka reaguar Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke kërkuar përfshirjen e Qeverisë në hartimin e statutit të Asociacionit. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë vetëm sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese sepse, sipas tij, çdo devijim është antikushtetues dhe i papranueshëm. "Qeveria do të duhej të ishte e përfshirë në përgatitjen e draftit të statutit të Asociacionit, e jo të kundërshtojë tash sikur ky draft të ishte përgatitur nga dikush i huaj. Lërja e këtij procesi pas dore e ka sjellë këtë situatë. Kryeministri deklaronte me krenari se nuk e ka hapur fare dosjen e statutit të Asociacionit. Tash ballafaqohet me probleme. Statuti vetëm sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese, çdo devijim është antikushtetues dhe i papranueshëm", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Sa i përket formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ditë më parë shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se askush nuk ka mandat të nënshkruajë diçka që është në kundërshtim me Kushtetutën. "Askush nuk ka të drejtë të dalë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës në këtë proces, si dhe askush nuk ka mandat të nënshkruajë diçka që është në kundërshtim me Kushtetutën", është shprehur Arifi, duke shtuar se nuk ka vonesa në këtë drejtim, por se është një proces më i komplikuar. "Grupi menaxhues ka filluar draftimin e statutit dhe ne ende nuk kemi marrë asnjë draft të këtij statuti, por kemi marrë transkriptimet apo procesverbalet e takimeve që ky grup menaxhues i ka pasur me disa grupe të interesit, mirëpo statut apo draft-statut të Asociacionit nuk kemi marrë. Është një proces më i komplikuar. Më 8 prill është riaktivizuar grupi menaxhues dhe është çështje kohësh kur ata do ta prezantojnë draftin e parë. Nuk ka asnjë ngecje. Arsyeja se a do të ketë ngecje apo jo varet nga ajo se çfarë ka draftuar grupi menaxhues. Nëse ekipi menaxhues ka draftuar një statut që është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës atëherë është çështje jave derisa të fillojë implementimi i tij. Nëse jo, atëherë do të kemi telashe, sepse mund të përsëritet situata e vitit 2015, ku në 22 raste kishte shkelje kushtetuese dhe në raste të tilla gjithçka kthehet në pikën zero", ka deklaruar Arifi.

# LV-ja: Çështjet kombëtare nuk marrin zgjidhje përfundimtare me integrimin në BE

TIRANË, 11 KORRIK (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka organizuar të mërkurën në Tiranë tryezën e dytë me titull "Shqiptarët dhe integrimi evropian", si vazhdim i tryezës të mbajtur më 15 maj 2018 në Prishtinë. Ashtu si në Prishtinë, edhe në këtë tryezë kanë marrë pjesë akademikë, studiues, artistë, gazetarë, aktivistë të shoqërisë civile, profesionistë të fushave të ndryshme dhe përfaqësues të subjekteve politike.



Tryeza në fjalë është hapur nga kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, i cili, ndër të tjera, ka shpjeguar edhe pesë konkluzat e dala nga tryeza në Prishtinë siç janë: (1) nevoja për një proces integrimi që shihet e vlerësohet si proces i bërjes anëtar dhe jo i vajtjes në BE; (2) rëndësia strategjike e integrimit të njëkohshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor; (3) zhvillimi ekonomik dhe drejtësia si prioritet; (4) harmonizimi i një politike të jashtme të përbashkët Shqipëri - Kosovë dhe e shqiptarëve në përgjithësi; dhe (5) puna me pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e njohin Kosovën.

Në këtë tryezë pjesëmarrësit janë pajtuar me konkluzat e nxjerra nga tryeza në Prishtinë, duke shtuar edhe konkluza të tjera si në vijim: 1. Çështjet kombëtare as nuk shuhen dhe as nuk marrin zgjidhje përfundimtare me integrimin në BE. Rasti aktual i Katalunisë në Spanjë është shembull që e vërteton këtë fakt. 2. Një nga pengesat më të mëdha të integrimit të shqiptarëve në procese më të gjera, përfshirë atë në BE, ka qenë status quo-ja në përfaqësimin politik shqiptar, e cila duhet të ndryshojë duke ndryshuar edhe cilësinë e përfaqësuesve në parlamente. 3. Keqkuptimi dhe keqinterpretimi i Bashkimit Evropian vetëm si proces teknik nga jashtë dhe si mbikëqyrje formale standardesh nuk e ka lejuar shoqërinë shqiptare të shprehet aktivisht në bazë të elementeve dhe aftësive përbërëse të integrimit. 4. Një nga shtysat më të rëndësishme të integrimit evropian nis me njohjen sa më të plotë të aftësive si kolektivitet kombëtar, dhe jo si përdorim instrumental i aktorëve civilë, politikë dhe ndërkombëtarë. 5. Bashkërendimi dhe bashkimi i tregjeve dhe prodhimeve të Kosovës e Shqipërisë. 6. Integrimi kulturor mbarëkombëtar është domosdoshmëri që duhet të realizohet paralelisht me integrimin evropian. 7. Platforma e çështjes kombëtare nuk mungon, siç këmbëngulet në të folurin mbizotërues, por ajo është shpallur që në Lidhjen e Prizrenit, ndaj sot nuk duhet të reduktohet në ekskluzivitet qeveritar, por në një akt të përbashkët intelektual politik.

Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

# Presidenti duhet ta

## - Presidenti duhet të jetë udhëheqës i një delegacioni konsensual i cili autorizohet nga Kuvendi i Kosovës për të negociuar me Serbinë

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka ftuar partitë politike për konsensus rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se konsensusin e parë që duhet ta arrijnë partitë është ai për vija të kuqe që Kosova duhet t'i ketë në këtë proces. Ajo ka vlerësuar se vija të kuqe duhen të jenë njohja reciproke, pakoja e Ahtisarit dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB. Tahiri ka theksuar se Kuvendi duhet ta miratojë platformën për këto bisedime dhe ta autorizojë presidentin dhe ekipin negociator i cili do ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces dialogues

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 11 korrik** - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka treguar rrugën se si subjektet politike duhet ta arrijnë konsensusin kombëtar për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë. Ajo ka bërë me dije se pas një debati Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë platformën për bisedime dhe ta autorizojë presidentin, së bashku me delegacionin negocues, që ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se qasja e Kosovës në këtë proces duhet të jetë profesionale. "Të gjitha partitë duhet të angazhohen në një debat parlamentar dhe të arrijnë një konsensus, pastaj Kuvendi ta aprovojë platformën dhe vijat e kuqe si dhe ta autorizojë një delegacion konsensual, i cili do të udhëhiqet nga presidenti për ta përfaqësuar shtetin e Kosovës në këto bisedime", ka thënë Tahiri. Sipas saj, subjektet politike së pari duhet të arrijnë një konsensus rreth vijave të kuqe që Kosova duhet t'i ketë në këtë proces. "Duhet të sillemi në mënyrë institucionale, sepse gati në të gjitha fazat e bisedimeve paqësore Kosova ka qenë e udhëhequr nga presidenti i vet. Në procesin e Vjenës udhëheqës i dialogut ka qenë presidenti, pastaj në bisedimet e Brukselit ka qenë kryeministri me autorizim të Kuvendit. Kështu që, mendoj se udhëheqja e delegacionit nga presidenti është në rregull dhe duhet të përkrahet. Pra, ai duhet të jetë udhëheqës i një delegacioni konsensual i cili autorizohet nga Kuvendi i Kosovës për të negociuar. Vlerësoj se në këtë proces duhet të ketë një përfaqësim të institucioneve dhe të spektrit të gjerë politik për aq sa është e mundur. Këtu kam parasysh opozitën", është shprehur Tahiri.

Më tutje, ajo ka treguar se cilat duhet të jenë vijat e kuqe të Kosovës në këtë proces dialogu. Sipas saj, vija e parë e kuqe në këtë proces duhet të jetë që marrëveshja përfundimtare duhet të përfundojë me njohjen reciproke në mes të dy shteteve. "Duke marrë parasysh se Serbia do të kërkojë më shumë të drejta për minoritetin serb, vijë tjetër e kuqe duhet të jetë Plani i Ahtisarit, i cili i ka dhënë të drejta minoritetit serb në Kosovë më shumë se minoriteteve të tjera. Në këtë drejtim mendoj se këto të drejta duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës. Vija e tretë e kuqe duhet të jetë që Serbia nuk duhet ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në OKB", ka deklaruar Tahiri.

**"Epoka e re":** *Znj. Tahiri, subjektet politike po bëjnë përpjekje të arritjes së një konsensusi kombëtar për fazën finale të dialogut. Sa është i nevojshëm për Kosovën një konsensus i tillë?*

**Tahiri:** Është me rëndësi strategjike që të arrihet një konsensus i gjerë rreth fazës përfundimtare të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së dhe të ShBA-së. Ky do të ishte konteksti ndërkombëtar i këtij dialogu. Ndërsa sa i përket kontekstit kombëtar, duhet të ketë një konsensus të gjerë rreth platformës për dialog, e cila duhet t'i bëjë të qarta vijat e kuqe që Kosova duhet t'i ketë në këtë proces të dialogut. Vija e parë e kuqe në këtë proces duhet të jetë që marrëveshja përfundimtare duhet të përfundojë me njohjen reciproke në mes të dy shteteve, sepse përfundimi i këtij procesi dhe vendosja e një kapitulli të marrëdhënieve fqinjësore dhe mbyllja e kapitullit të armiqësive mund të bëhet vetëm përmes njohjes reciproke të dy shteteve. Duke marrë parasysh se Serbia do të kërkojë më shumë të drejta për minoritetin serb, vijë tjetër e kuqe duhet të jetë plani i Ahtisarit, i cili i ka dhënë të drejta minoritetit serb në Kosovë më shumë se minoriteteve të tjera. Në këtë drejtim mendoj se këto të drejta duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës. Vija e tretë e kuqe duhet të jetë që Serbia nuk duhet ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në OKB. Jo që Serbia mund ta pengojë, mirëpo kjo duhet të jetë pjesë e marrëveshjes si vijë e kuqe, për faktin se Serbia edhe kur bën marrëveshje, ka tendenca t'i shkelë ato, siç e kemi parë kur e kemi arritur marrëveshjen për anëtarësim në organizatat rajonale në vitin 2012. Prandaj, këto janë tri vijat e kuqe që duhet t'i ketë platforma e Kosovës për bisedime. Po ashtu, kjo platformë duhet t'i referohet së kaluarës, ku Serbia duhet t'i paguajë dëmshpërblimet për gjenocidin që e ka bërë në Kosovë në të gjitha aspektet. Pastaj platforma duhet ta përfshijë çështjen e të pagjeturve dhe çështjen e grave të dhunuara. Çështje tjetër që duhet të parashihet në platformë është demarkacioni në mes të dy vendeve dhe, në fund, Kosova nga kjo marrëveshje duhet t'i nxjerrë të gjitha ato që i takojnë si pasuri nga zhbërja e ish-Jugosllavisë. Pra, në bazë të suksesionit 1/8 e pasurisë së ish-Jugosllavisë duhet t'i takojë Kosovës. Ne një platformë që i përfshinë të gjitha këto çështje veç e kemi dorëzuar në Bruksel në vitin 2014. Tani mendoj se të gjitha partitë duhet të angazhohen në një debat parlamentar që të arrijnë një konsensus, pastaj Kuvendi ta aprovojë platformën dhe vijat e kuqe, si dhe ta autorizojë një delegacion konsensual i cili do të udhëhiqet nga presidenti për ta përfaqësuar shtetin e Kosovës në këto bisedime.

**"Epoka e re":** *Debati që po zhvillohet mes subjekteve politike sillet mes asaj se kush do ta udhëheqë delegacionin dhe cili duhet të jetë roli i Kuvendit në këtë proces. Është kjo qasja e duhur që mund të na çojë drejt një konsensusi për këtë çështje?*

**Tahiri:** Mendoj se rruga e duhur për të arritur një konsensus është që së pari të arrihet konsensus për platformën dhe vijat e kuqe që duhet t'i ketë Kosova në këtë fazë të dialogut. Pastaj duhet të sillemi në mënyrë institucionale, sepse gati në të gjitha fazat e bisedimeve paqësore Kosova ka qenë e udhëhequr nga presidenti i saj. Në procesin e Vjenës udhëheqës i dialogut ka qenë presidenti, pastaj në bisedimet e Brukselit ka qenë kryeministri me autorizim të Kuvendit. Kështu që, mendoj se udhëheqja e delegacionit nga presidenti është në rregull dhe duhet të përkrahet. Pra, ai duhet të jetë udhëheqës i një delegacioni konsensual i cili autorizohet nga Kuvendi i Kosovës për të negociuar. Vlerësoj se në këtë proces duhet të ketë një përfaqësim të institucioneve dhe të spektrit të gjerë politik për aq sa është e mundur. Këtu kam parasysh opozitën.

**"Epoka e re":** *Cili është vlerësimi juaj për qëndrimin e opozitës, e cila tani për tani po refuzon të bëhet pjesë e këtij procesi?*

**Tahiri:** Tani kemi të bëjmë me bisedime me armikun e Kosovës, i cili ka bërë një luftë agresore dhe gjenocidale në Kosovë. Dhe, natyrisht, kur dy shtetet që kanë qenë në konflikt lëvizin drejt vendosjes së paqes mes tyre, sigurisht se delegacioni duhet të jetë më i gjerë dhe më përfaqësues. Marrëveshja që arrihet në Bruksel duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Tekefundit, ky është një proces historik ku secili subjekt politik duhet ta japë kontributin e vet për të arritur një marrëveshje maksimalisht të favorshme për Kosovën, e cila do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa sa i përket komunitetit serb, ne kemi pakon e Ahtisarit që është pjesë e Kushtetues së Kosovës, e cila serbëve u jep të drejta jashtëzakonisht të mëdha. Pra, tani me rëndësi është ta gjejmë gjuhën e përbashkët mes spektrit politik në vend për këtë proces.

**"Epoka e re":** *Në Kosovë ka paska drojë për këto negociata, pasi aludohet se sërish do të bëhen kompromise të reja, përtej pakos së Ahtisarit. Sa do të jetë sfiduese për Kosovën kjo fazë finale e dialogut?*



**Tahiri:** Frika është pjesë e këtij procesi jo vetëm në rastin e një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në çdo rast, kur dy shtete që kanë pasur luftë, pala që ka qenë viktimë e konfliktit ka frikë më të madhe. Natyrisht se tek popullata ndihet frika. Kjo ka ekzistuar edhe për Konferencën e Rambujesë, për procesin e Vjenës si dhe kur e kemi filluar procesin e Brukselit. Pra, çdoherë ka pasur frikë, kriticizëm dhe skepticizëm. Mirëpo, kur është mbrojtur mirë interesi i shteti siç kemi bërë ne, kur të gjitha marrëveshjet janë në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën, nuk duhet të ketë frikë. Për të

# udhëheqë dialogun



ndodhur kështu duhet përgatitje e lartë profesionale dhe politike. Mesazhi im për këtë fazë është që Kosova duhet të përgatitet që të dalim të suksesshëm edhe në këtë proces.

**"Epoka e re":** *A mund ta presim inkuadrimin tuaj në fazën finale të këtij dialogu?*
**Tahiri:** Tani nuk është koha e emrave. Tani duhet të shohim se Kosova edhe këtë herë duhet të tregojë pjekuri politike siç ka treguar edhe në proceset e deritashme kur kemi biseduar me Serbinë. Tek në fazën e mëvonshme mund të vijnë në shprehje emrat e përveçëm.

## Paqja e qëndrueshme në rajon është e lidhur me suksesin e Aleancës Veri-Atlantike

**"Epoka e re":** *Në Bruksel ka filluar Samiti i NATO-s. Këtë herë samiti i aleancës që garanton stabilitetin e rajonit po mbahet në një frymë, ku kemi përplasje në mes të liderëve të shteteve anëtare të NATO-s. Sa është e rëndësishme për të ardhmen e rajonit uniteti i kësaj aleance?*
**Tahiri:** Është e vërtetë se ky samit po përcillet me disa kundërthënie që vijnë nga deklaratat e aktorëve kryesorë që e kanë themeluar këtë aleancë, mirëpo siguria globale bazohet sot në bllokun euroatlantik. Prandaj, është me rëndësi që ky samit të përfundojë me një pajtim të përbashkët rreth të gjitha obligimeve që kanë palët. Pra, ashtu siç ka thënë presidenti Trump, shtetet anëtare duhet t'i kryejnë obligimet e vet, veçmas ato financiare. Ndërsa të gjitha vendet anëtare duhet ta kenë parasysh që blloku euroatlantik është një bllok strategjik për paqen globale, sidomos për neve, Kosovën dhe Shqipërinë, sepse blloku euroatlantik është aleanca jonë. Në këtë kontekst mendoj se paqja e qëndrueshme në rajon është e lidhur me suksesin e Aleancës Veri-Atlantike dhe suksesin e këtij samiti.

**"Epoka e re":** *Ndonjë lëkundje në këtë bllok mund të paraqesë shqetësim për vendet e rajonit?*
**Tahiri:** Besoj se do të mbizotërojë mendimi strategjik i të gjithë liderëve të vendeve që e përbëjnë NATO-n. Çfarëdo lëkundje në këtë drejtim do t'u hapte rrugë ambicieve të Rusisë dhe vendeve joperëndimore për të kërkuar hapësira dominimi. Këto do të ishin shumë të dëmshme për vlerat perëndimore dhe për vlerat e liberal-demokracisë, për të cilat edhe ne jo vetëm si shtet, por edhe si komb shqiptar jemi përcaktuar strategjikisht. Prandaj, po besoj se edhe në këtë samit do të mbizotërojë vizioni strategjik dhe përkushtimi për vlerat perëndimore.

# Ministri Ismaili: Furnizimi me barna është stabilizuar

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, të mërkurën para anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës ka bërë me dije se ka nisur të përmirësohet furnizimi me barna. "Në fund të vitit 2017, 70 për qind të barnave kanë qenë pa kontratë. Sot kemi 65 për qind të barnave me kontratë, kurse 24 për qind janë në procedurë. Tashmë kemi një situatë tërësisht tjetër në sektorin shëndetësor", ka thënë Ismaili



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka raportuar të mërkurën para Komisionit për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës. Ismaili ka treguar për përmirësimin e furnizimit me barna dhe për stabilizimin e gjendjes që është arritur. Paraprakisht ministri Ismaili ka përmendur gjendjen dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar me marrjen e detyrës në Ministri të Shëndetësisë. "Në fund të vitit 2017, 70 për qind të barnave kanë qenë pa kontratë. Sot kemi 65 për qind të barnave me kontratë, kurse 24 për qind janë në procedurë. Tashmë kemi një situatë tërësisht tjetër në sektorin shëndetësor", ka thënë Ismaili.

Ai ka shtuar se tani janë marrë të gjitha masat që furnizimi të stabilizohet dhe të ndërpritet avazi i vjetër i keqmenaxhimit. Madje ai ka thënë se sot të gjithë mund të jenë pak më shumë krenarë për instalimin e një qeverisje të re në Ministri të Shëndetësisë. "Konsideroj se sot mund të jemi të gjithë më krenarë pasi kemi arritur një model të ri të qeverisjes në Ministri të Shëndetësisë. Edhe kemi ndërprerë një avaz të vjetër të keqmenaxhimit, edhe kemi më shumë furnizim me barna. Po e kursejmë edhe buxhetin e shtetit. Vetëm në 30 produkte kemi kursyer rreth një milion euro të buxhetit me metodat e reja të blerjes së barnave", ka thënë ai.

Ismaili ka treguar se gjatë një jave në muajin qershor janë nënshkruar rreth 50 kontrata të reja për furnizim me barna dhe aktualisht kanë hyrë në fazën e fundit të nënshkrimit të të gjitha kontratave për barna dhe material shpenzues, të cilat shumica janë kontraktuar me çmime më të lira sesa kontratat paraprake. Ministri ka përmendur edhe Udhëzimin Administrativ për rregullimin e çmimeve të barnave. "Në bazë të këtij udhëzimi janë krijuar disa mekanizma mbrojtës për institucionet publike në mënyrë që prokurimi i barnave të mos bëhet me çmime abuzive, por të jetë me çmime sa më të ulëta, duke pasur referencë edhe shtetet e rajonit dhe ato evropiane", ka treguar ai.

Më pas ministri Uran Ismaili ka folur edhe revidimin e Listës Esenciale të Barnave e cila nuk është bërë që nga viti 2012. "Nga Zyra e OBSh-së në Prishtinë kam kërkuar të na ndihmojë në këtë proces me ekspertët e vet në mënyrë që versioni i radhës të hartohet duke u bazuar në standardet dhe praktikat më të mira të definuara nga kjo organizatë", ka thënë ai.

Në raportimin e tij para Komisionit për Shëndetësi, ministri Ismaili ka folur edhe për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. "Gjatë këtyre muajve, 60 për qind e parakushteve për funksionim të Sigurimeve Shëndetësore janë përfunduar, duke përfshirë paketën bazë të përfitimeve, listën e shërbimeve pa pagesë, çmimet e shërbimeve, nivelet e bashkëpagesave etj", ka thënë Ismaili.



# Presidenti Thaçi uron fermerët për nisjen e fushatës së korrje-shirjeve të grurit

FERIZAJ, 11 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, bashkë me zëvendësministrin e Bujqësisë dhe kryetarin e Ferizajt, të mërkurën kanë përcjellë për së afërmi fushatën e korrje-shirjeve të grurit në Komunën e Ferizajt.

Presidenti Thaçi ka shprehur besimin se ky do të jetë një sezon i mbarë. "Si institucione të vendit, si president i vendit, e kam parë të udhës të jem gjithmonë pranë fermerëve, në mbështetje të tyre, për t'i plotësuar nevojat dhe kërkesat e tyre. Është shumë me rëndësi që sivjet rendimentet janë të mira. Janë të standardit të viteve të kaluara. Do të punojmë që t'u kompensohen dëmet atyre që kanë pësuar nga reshjet", është shprehur presidenti Thaçi. Ai e ka uruar fermerin Xhevat Uka nga fshati Prelez i Komunës së Ferizajt dhe të gjithë fermerët e Kosovës për punën e mirë dhe për fillimin e sezonit të korrje-shirjeve të grurit.

Zëvendësministri i Bujqësisë, Mevludin Krasniqi, ka treguar se nga kjo javë do të nisë ndarja e subvencioneve për kultivuesit e grurit, me nga 150 euro për çdo hektar gruri të mbjellë. Kurse kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se vizita e presidentit, mbështetja e Qeverisë dhe e komunës i nxisin fermerët të punojnë edhe më shumë.

Fermeri Xhevat Uka e ka falënderuar presidentin Thaçi, zëvendësministrin Krasniqi dhe kryetarin Aliu për vizitën në fermën e tij dhe për përkrahjen e vazhdueshme. Presidenti Thaçi në fund ka theksuar se po shihet një angazhim i shtuar i të gjithë fermerëve të Kosovës që ta përfundojnë këtë sezon sa më mirë.

# Prof. ass. dr. Skender Gojani i bashkohet Nismës

PRISHTINË, 11 KORRIK - Nismës Socialdemokrate të mërkurën i është bashkuar prof. ass. dr. Skender Gojani. Mirëseardhje në Nisma Socialdemokrate, Gojanit i kanë uruar kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës, Jakup Krasniqi, deputeti Enver Hoti dhe anëtari i kryesisë, Fazli Hoxha. "Nisma Socialdemokrate çdo ditë e më shumë po fuqizohet me kuadro sikurse profesor Gojani. Bagazhi i profesor Gojanit do ta ndihmojë edhe më shumë Nismën për rritjen dhe zhvillimin e saj si forcë politike në vend, e cila ka filluar të pëlqehet më të madhe nga qytetarët e Kosovës", ka shkruar Fazli Hoxha në llogarinë e vet në "Facebook", anëtar i kryesisë së Nismës dhe kryetar i degës së kësaj partie në Gjakovë.



# Në tetor do të dihen saktë ndotësit kryesorë në Kosovë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka mbajtur të mërkurën takim me përfaqësuesit e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), për të diskutuar rreth fazës së parë të projektit për Zhvillimin e Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit.

Ministrja Reshitaj ka theksuar se rezultatet preliminare mbi ndotësit kryesorë në Kosovë do të jenë gati në tetor të këtij viti, pas studimit të hollësishëm njëvjeçar nga ekspertët japonezë. "Projekti që po realizohet në bashkëpunim me JICA-n japoneze në fushën e mjedisit, posaçërisht për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, është shumë i rëndësishëm për shtetin e Kosovës, pasi fusha e mjedisit mbetet ende problematike. Prandaj, me anë të këtij projekti katër milionësh ne do t'i listojmë emetuesit e mëdhenj të gazrave dhe në këtë mënyrë do t'i dizajnojmë politikat zhvillimore për kontrollimin e ndotjes së ajrit", ka thënë ministrja Reshitaj. Ajo ka deklaruar se në fund të këtij projekti do të ketë një plan të qëndrueshëm dhe efikas të monitorimit të ndotjes së ajrit.

Ndërsa përfaqësuesi i JICA-s, Yamanda Taizo, ka falënderuar ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, për bashkëpunimin e deritanishëm për zbatimin e projektit për kontrollin e ndotjes së ajrit. "Projekti ka për qëllim që t'i zhvillojë kapacitetet e palës së Kosovës për trajtimin e ndotjes së ajrit. Ky projekt ka filluar vitin e kaluar dhe për më pak se një vit pala e Kosovës ka nisur shumë punë të rëndësishme për kontrollin e ndotjes së ajrit me ekspertët e JICA-s", ka thënë Taizo. Në kuadër të këtij projekti katërmilionësh parashihet analizimi i cilësisë së ajrit, listimi i burimeve të mëdha të ndotjes dhe vlerësimi i masave të kontrollit të ndotjes së ajrit.


AFP

# Hoxha: Rinia e Kosovës padrejtësisht është e privuar nga lëvizja e lirë



PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur të mërkurën një ligjëratë me studentët e "Kosovo International Summer Academy". Kjo akademi verore ka 64 pjesëmarrës nga 31 shtete nga të gjitha kontinentet. Ministrja Hoxha në ligjëratën e saj ka diskutuar për të arriturat dhe sfidat e procesit integrues, për vlerën e shtetit dhe të shtetësisë, si dhe për përkushtimin e pandalshëm për procesin integrues euroatlantik. Ajo ka thënë se rinia e Kosovës padrejtësisht është e privuar nga lëvizja e lirë, nga ngritja e kapaciteteve të tyre për të qenë të barabartë me moshatarët e tyre, për vlerat evropiane dhe për ballafaqimin me sfidat që ofron globalizmi. "Ne jemi gati për marrjen e përgjegjësive, duke qenë pjesë e pandashme e vlerave evropiane", ka thënë ministrja Hoxha.

# 52 fëmijë punojnë nën moshë të lejuar

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 11 KORRIK - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, të kryesuar nga kryetarja Duda Balje. Në këtë mbledhje ishte i ftuar ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, për të diskutuar rreth gjendjes së të rinjve dhe të miturve të cilët punojnë në sektorin privat.

Ministri Reçica para anëtarëve të komisionit ka paraqitur të dhënat e raportit të Qendrës për Punë Sociale. Sipas këtij raporti, gjatë pjesës së parë të këtij viti janë evidentuar 52 fëmijë që punojnë nën moshë të lejuar, 38 prej tyre kërkojnë lëmoshë, 11 fëmijë punojnë në rrugë dhe tre të tjerë merren me pasuri natyrore.

Tema kryesore e këtij diskutimi ishte rasti i 30 qershorit të këtij viti, me ç'rast një 17-vjeçar humbi jetën në një ndërmarrje private në rrethinën e Prizrenit. Ministri Reçica ka pohuar se detyra e inspektoratit të punës nuk është vetëm të gjobisë kompani, por më shumë është punë vetëdijesuese. Ai ka thënë se kur një kompani nuk i plotëson kërkesat e vëna që inspektorati i ka dhënë në takimin e parë, atëherë kur e viziton për herë të dytë, ajo kompani gjobitet.

Anëtarët e komisionit e pyetën ministrin Reçica për punën në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe i kërkuan një raport me shkrim për inspektimin e kompanive që ua kanë bërë gjatë mandatit të tyre.

Në këtë mbledhje komisioni shqyrtoi Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilin para anëtarëve të komisionit e prezantuan zyrtarë të Zyrës së kryeministrit. Sipas tyre, ky projektligj parashihet edhe në Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe del si kërkesë e raportit për Kosovën. U bë e ditur se projektligji përmban gjithsej 65 nene, të cilët shtjellojnë qëllimin, fushëveprimin, përkufizimet, të drejtën për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, interesin më të mirë të fëmijës etj. Pas diskutimeve të zhvilluara rreth këtij projektligji, anëtarët e komisionit u pajtuan që të njëjtin ta procedojnë për seancë plenare.


AFP

# Nis projekti i eliminimit të deponive të mbeturinave të ngurta

FERIZAJ, 11 KORRIK (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Komunën e Ferizajt ka nisur implementimin e projektit të eliminimit të deponive të mbeturinave të ngurta në gjithë territorin e kësaj komune. Ky aksion ka filluar nga fshati Dardani i Komunës së Ferizajt dhe do të vazhdojë edhe në zona të tjera.
Në inspektim nga afër të këtij aksioni kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i komunës, Naim Ferati dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Arben Halili dhe zyrtarë nga kompanitë publike. Ky projekt po realizohet për të mundësuar mjedise të pastra, mirëmbajtje të zonave përskaj rrugëve lokale si dhe shmangie të rreziqeve që mund të shkaktojnë këto mbeturina të ngurta për aksidente dhe përmbytje. Autoritetet lokale kanë apeluar tek qytetarët që të mos hedhin mbeturinat në hapësira publike si dhe t'i denoncojnë rastet ku hasin në ndotjen e mjedisit.





# Në Besianë shënohet Dita Fushore e kultivuesve të specit dhe lakrës

Besianë, 11 korrik (ER) - Në fshatin Sekiraçë të Komunës së Besianës është organizuar të mërkurën Dita Fushore me fermerët kultivues të specit dhe lakrës. Nikoqire e kësaj ngjarje ka qenë qendra grumbulluese "Albini", e pronarit Bekim Vokrri, kurse fermerët kanë marrë këshilla rreth trajtimit të këtyre perimeve dhe mbrojtjes nga sëmundje të ndryshme, si dhe janë njoftuar për përdorimin e plehrave dhe kemikalieve. Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Vezir Januzi, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm organizimin e Ditës Fushore. Ai u ka premtuar fermerëve mbështetje për kultivimin e kulturave të perimtarisë, siç janë speci dhe lakra, të cilat janë të kërkuara në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

# Komuna e Klinës fton qytetarët për dhurim vullnetar të gjakut

KLINË, 11 KORRIK (ER) - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Klinës nëpërmjet një ftese publike i ka ftuar institucionet dhe qytetarët e kësaj komune që gëzojnë shëndet të mirë, që sot (e enjte) të paraqiten për dhënien vullnetare të gjakut, dedikuar të sëmurëve dhe të lënduarve që shërohen në spitalet tona.
Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Klinës, Hekuran Sejdiu, me moton "dhuro gjak, shpëto jetë" ka folur mbi rëndësinë që ka dhurimi i gjakut për ata që kanë nevojë. Ky aktivitet do të organizohet nga Qendra e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut dhe DKSHMS-Klinë. Dhënia vullnetare e gjakut do të realizohet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) duke filluar nga ora 10:00.





# Zgjatet orari i punës në Komunën e Rahovecit

Rahovec, 11 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimin me të cilin ka zgjatur orarin e punës për zyrtarët e Zyrës së Gjendjes Civile, zyrtarët e Zyrës së Pranimit dhe zyrtarët e Tatimit në Pronë të Komunës së Rahovecit. "Me këtë vendim zgjatet orari i punës për zyrtarët e Gjendjes Civile, Zyrës së Pranimit dhe zyrtarët e Tatimit në Pronë të Komunës së Rahovecit, çdo ditë pune prej orës 16:00 deri në orën 18:00 dhe të shtunën nga ora 9:00 deri në orën 12:00. Zgjatja e orarit të punës për punonjësit fillon nga data 16 korrik deri më 17 gusht 2018. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa", është thënë në njoftimin e Komunës së Rahovecit. Arsyeja e nënshkrimit të vendimit për vazhdimin e orarit të punës është bërë për shkak të fluksit të madh të bashkatdhetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në mërgim e që kanë ardhur dhe do të vijnë për pushime në Kosovë, ndër të tjera, edhe për të kryer shërbime administrative në komunë.

## Gashi falënderon Lekajn për mbështetjen në projektet infrastrukturore

KASTRIOT, 11 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka inspektuar punimet që janë duke u zhvilluar në infrastrukturë në këtë komunë. Gashi ka falënderuar ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj, i cili ka përkrahur kërkesën e tij për asfaltimin e rrugës "Hasan Prishtina" dhe rrugës "Mihjet" në Komunën e Kastriotit.



# Beqaj raporton për objektivat e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka raportuar të mërkurën para Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, ku ka paraqitur objektivat e ministrisë që drejton

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN), Besim Beqaj, ka raportuar të mërkurën para Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi. Të arriturat e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, objektivat programore dhe aktivitetet e saj që nga themelimi ishin pikat kryesore të raportimit të ministrit Beqaj.

Ministri Beqaj ka folur për të arriturat kryesore të MIN, me theks të veçantë për realizimin e objektivave programore të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të programit qeveritar, si: themelimi i Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi, themelimi i qendrave të inovacionit dhe ndërmarrësisë, marrëveshja për bashkëfinancim me Qeverinë Gjermane



përmes GIZ-it, krijimi i bazës ligjore në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe përkrahja financiare për sektorin privat përmes granteve. "Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do t'i mbështesë financiarisht Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) që kanë shënuar bilanc pozitiv. Në këtë kuadër tashmë jemi në proces të ndarjes së granteve për OJQ-të, ndërsa brenda pak ditësh do të lansohet edhe programi për përkrahje të start-upve dhe NVM-të", ka theksuar ministri Beqaj.

Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi e kanë vlerësuar pozitivisht punën e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe e kanë falënderuar ministrin Beqaj për raportimin korrekt, duke shprehur interesimin e tyre për punën e Ministrisë, në veçanti për aktivitetet në shërbim të përkrahjes së sektorit privat me qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit.

# Reshitaj: Do ta fuqizojmë ekoturizmin

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, së bashku me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, kanë nënshkruar të mërkurën një memorandum mirëkuptimi për mbikëqyrjen e duhur të burimeve në fshatrat Gradocë dhe Dollancë të Suharekës.

Pas ceremonisë së nënshkrimit, ministrja Reshitaj ka thënë se qëllimi i këtij memorandumi është fuqizimi i ekoturizmit në Komunën e Suharekës. "Këto iniciativa janë në përputhje me planin zhvillimor dhe me politikat progresive të ndërmarra nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ndihmojnë në fuqizimin e turizmit malor. Këto investime do ta rrisin kualitetin e jetës në përgjithësi, posaçërisht do të ndihmojnë në zhvillimin e ekoturizmit si nevojë e veçantë dhe mundësi reale për Komunën e Suharekës, marrë parasysh relievin e kësaj komune", ka thënë Reshitaj.

Me këtë rast ministrja Reshitaj ka thënë se shumë shpejt MMPH-ja do të ketë investime në rregullimin e shtratit të lumit Tophulla, për mbledhjen e fidanëve përreth rrugës Suharekë - Prizren dhe për zgjerimin e parqeve të gjelbra në qytetin e Suharekës. "Të gjitha këto projekte investuese në Suharekë dhe në Bjeshkët e Sharrit do të kontribuojnë për ngritjen e cilësisë së ajrit si dhe do të fuqizojnë agro dhe ekoturizmin", është shprehur ministrja Reshitaj.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Suharekës për investime në projektet kapitale në fushën e riciklimit të mbeturinave.





# Lluka thotë se situata në Postë është shqetësuese

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka ngritur shqetësimin për situatën e krijuar në Postën e Kosovës, por ka premtuar se do të bëjë të pamundurën për të bërë zgjidhje. Të mërkurën para Komisionit për Zhvillim Ekonomik, ministri Lluka ka theksuar se Posta e Kosovës gjendet në rrethana shqetësuese për shkak të zvogëlimit të shitjes në vitet e fundit. "Posta e Kosovës, si shumica e ndërmarrjeve të tjera, ka një gjendje shqetësuese për shkak të qarkullimit dhe zvogëlimit të shitjes në vitet e fundit. Rreth 80 për qind e qarkullimit është në paga. Nga ana tjetër, është shërbimi universal postar. Edhe me ligj parashihet që mund të subvencionohet nga Qeveria apo aksionari në këtë rast", është shprehur ai. Lluka ka thënë se sa i përket tremujorit të parë të këtij viti, Posta ka pasur rënie edhe në shitje.

# Berat Rukiqi zgjedhet kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Pas një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent zgjedhor, për përzgjedhjen e organeve qeverisëse të Odës Ekonomike Kosovës, proces në të cilin morën pjesë mbi 1 800 anëtarë të Odës Ekonomike, në bazë të parimit një anëtar një votë, nga të gjitha shoqatat sektoriale si dhe nga njësitë rajonale të Odës (29 shoqata dhe 7 njësi rajonale), të mërkurën u zgjodhën strukturat drejtuese, përkatësisht organet e Odës Ekonomike të Kosovës.

Procesi zgjedhor u kurorëzua me zgjedhjen e kryetarit të ri të Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, i cili ishte kandidati i vetëm për këtë post. Rukiqi ka një përvojë të gjatë në sektorin publik dhe privat, duke qenë i angazhuar për 1 vit në Zyrën e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, 11 vjet në pozita të ndryshme në Odën Ekonomike të Kosovës, 10 vjet staf i rregullt në Universitetin Publik "Hasan Prishtina", katër vjet kryesues i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, anëtar i Bordit të "Millenium Foundation Kosovo" si dhe është bashkëthemelues dhe bashkëpronar në kompaninë "Trosha".



# Nuk është Hashim Thaçi as De Klerk e as Mendela që të vendosë për amnisti për krime lufte (2)



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Ky grup teknik ka afat 12 + 6 muaj për ta hartuar dokumentacionin e nevojshëm pas të cilit e përfundojnë mandatin pa të drejtë të bëhen anëtarë të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin do të përbëhej nga njohës të të drejtave të njeriut, përkatësisht drejtësisë tranzicionale, që gëzojnë autoritet dhe besueshmëri në popull, me integritet të lartë moral dhe profesional e që, të tillë, për mendjen time, nuk ka në Kosovë për shkak se këta kanë shkuar të gjithë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Andaj, kuadro të tillë, ose duhet t'i importojmë nga Kina, ose t'i marrim bijtë dhe bijat e ish-udhëheqësve shqipfolës të ish-Jugosllavisë dhe ish-Serbisë e që, pa asnjë problem, do të garantonin pajtimin me Serbinë sipas së vërtetës së Serbisë dhe të tyre që, fare pak ose aspak, nuk dallojnë. Kur e kam fjalën te Gjykata Kushtetuese e Kosovës, si konfirmuese apo mohuese e fundit e marrëveshjeve ndërkombëtare e që, e tillë do të jetë edhe ajo "historikja" midis Serbisë dhe Kosovës, nuk kam dyshim se me këtë përbërje dhe ndikim 100 % të politikës do ta përkrahë çdo marrëveshje, interpretimin e së cilës, sikur për rastin e Asociacionit ku shkelet Kushtetuta në 23 raste, por se duhet të vazhdohet me themelimin e këtij entiteti politik dhe etnik të Serbisë brenda Kosovës, do ta bëjnë ndërkombëtarët e që aminin do t'i këndojnë "gjykatësit" e kësaj gjykate. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, sa i përket profesionalizmit, sot është nën nivelin e një Gjykate për Kundërvajtje dikur. Këta sot nuk kanë kapacitet ta shkruajnë edhe as një vendim profesional juridik, pa ndihmën e ndërkombëtarëve. Këta analfabetë funksionalë juridikë janë të zgjedhur nga politika, që nga ditët e para e deri te këta të fundit, prandaj 100 % varen nga ndërkombëtarët dhe nga politika. Po të kishin ndershmëri njerëzore, disa prej tyre edhe po t'ua shtronin rrugën me dafina deri te karrigia e Gjykatës Kushtetuese nuk do ta pranonin. Por ndershmëria sot në Kosovë kryesisht është shprehje gjuhësore. Po të ishte për së mbari, z. Laban, si i dënuar për krim të organizuar në Serbi me një dënim të formës së prerë, jo që do të duhej të ishte në listën e kandidatëve për gjykatës të kësaj Gjykate, por se do të duhej t'i dorëzohej Serbisë në mënyrë që karrierën juridike ta vazhdojë në burgun e Nishit, Pozharevcit apo Sremska Kamenicës. Në këtë mënyrë do ta shkarkonte nga barra e madhe presidentin Thaçi i cili nuk ka guxim ta shkarkojë, por se vetëm po e kërkon një mundësi, qoftë edhe ndonjë dëshmi të falsifikuar nga Serbia se ndaj tij nuk po zhvillohen hetime e që pastaj ta dekretojë për Gjykatës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ku, ndonëse i dënuar, vazhdon të paguhet me një rrogë të majme nga buxheti i Kosovës. Nëse Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit i përmbahet mandatit atëherë amnistia për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid nuk mund të ndodhë në Kosovë sikur që nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër të botës. Jam i sigurt se po të kishte mundësi bashkësia ndërkombëtare që rastin e Kosovës përkatësisht amnistinë e përfolur për krime të luftës ta trajtojë si rast të izoluar, atëherë edhe do ta bënte këtë vetëm për ta arritur një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë duke i amnistuar (sigurisht dhe vetëm përkohësisht kriminelët) krejtësisht në dëm të viktimave sikur që ka vepruar deri më tani. Kush është përgjigjur dhe dënuar për krime të shumta në Kosovë?! Askush ose fare simbolikisht! Nuk mund të ketë amnisti për krime lufte në Kosovë sikur në asnjë vend tjetër të botës sepse në këtë mënyrë do të dhunohej e drejta ndërkombëtare dhe ligji për të drejtën humanitare sikur edhe do të shpërfillej parimi për vjetërsimin e krimeve të luftës që, në praktikat deri më sot, kurrë nuk janë vjetruar dhe të dyshuarit janë ndjekur deri në vdekje. Të gjitha gjykatat për krime lufte, përjashtuar Gjykatën e Nyrembergut që ka dënuar sipas përgjegjësisë vertikale (komanduese) dhe shtrirjes horizontale (vepruese - zbatuese, të gjitha formacionet politike dhe ushtarake), janë pak a shumë politike sepse janë varur dhe kanë vepruar sipas interesave politike. Megjithatë, nëse jo plotësisht, atëherë edhe simbolikisht kanë dënuar nga të gjithë palët ndërluftuese duke e vendosur një ekuilibrim të përgjegjësisë, në dëm të viktimave për të ndërtuar dhe mbajtur një paqe e cila, në disa raste si ajo në Afrikë (Ruanda), është përsëritur me një numër milionësh të viktimave të pafajshme. Apo rasti i Srebrenicës. Jemi dëshmitarë se, ndonëse disa shtete nga ish-Jugosllavia kanë vendosur marrëdhënie normale, gjuetia ndaj kriminelëve të luftës po vazhdon edhe sot e kësaj dite për faktin se është parim i pranuar juridik ndërkombëtar se krimet e luftës nuk mund të vjetrohen. Mund të ketë amnisti për pjesëmarrje në luftë, por për ata ndaj të cilëve dëshmohet se kanë kryer krime lufte kurrë nuk do të ketë amnisti. Do të përdoren për qëllime politike dhe pasi t'i kenë përfunduar, do të përfundojnë në burg. Pa asnjë dyshim.
Rudolf Hes, një ndër krerët nazist, i dënuar me burg të përjetshëm, thuaja afërsisht 30 vjet është mbajtur si i burgosur i vetëm në Burgun Shpandau deri në moshën 93-vjeçare kur edhe ka vdekur. Ky duhet të jetë shembull se si duhet të trajtohen kriminelët e luftës sipas së drejtës ndërkombëtare. As Kosova nuk duhet të bëjë përjashtim në këtë drejtim. Drejtësia tranzicionale, sipas së cilës formohet dhe funksionon Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin apo me ndonjë emërtim tjetër, duhet t'u përmbahet katër shtyllave të saj: e drejta për t'i informuar, e drejta për drejtësi, e drejta për reparacion dhe e drejta për mospërsëritje. Amnistia për krime lufte i mohon të gjitha këto katër shtylla mbi të cilat ndërtohet e drejta për viktima sikur që nuk siguron se krimet nuk do të përsëriten edhe në të ardhmen. Vuçiqi është i interesuar të amnistohen të gjithë serbët për krime lufte, madje ai thotë se serbët nuk kanë bërë krime të luftës sepse e kanë mbrojtur shtetin kurse Thaçi, për qëllime politike, ka interes të dënohen serbët për krime lufte në Kosovë, mos të dënohen shqiptarët (sidomos ata që e përkrahin Hashimin) apo, eventualisht, të dënohet ndonjë shqiptar, komandant lufte që është pengesë në rrugën e Hashimit. Drejtësia ndërkombëtare nuk falë krimet e luftës pavarësisht prej pozitës (rasti Milloshevic, Karaxhiuq, Mlladiq, Tuxhman, Izetbegoviq etj.). I përdorë, pastaj ua tregon derën... e burgut. Po të varej amnistia për krime lufte nga Hashim win - win -i dhe Bekim pinguini, pisk do t'i kishim punët!
Pse të shkruaj pasi po shkruajnë Begjeti dhe Hysniu: Sa po më rritet mendja se po shkruaj mirë (ashtu më thonë disa shokë që ua paguaj kafetë rregullisht, nuk e di pse), po del një shkrim që po më qetë në b..thë. Nëse e lexoni analizën e Begjet Pacollit për paqen atëherë duhet t'i hidhni të gjitha fletoret, lapsat, PC dhe analizat e tjera botërore për këtë lëmë. Ah, Mentor (Begjet), Mentor (Begjet), do të më marrësh në qafë duke ma humbur karrierën prej analisti! Pse, or vëlla, shqiptarë jemi, pse më nxjerrë nga loja me shkrimin tënd sikur dr. Xhekilli, me dy fytyra, shkruan si Mentor e nënshkruhesh si Begjet!
Hysni veterani, pajtohem 100 % me atë që ka dalë sot në gazetë me emrin tënd. Se kush e ka shkruar nuk e di, po se t'i nuk e ke shkruar vetë, jam i sigurt. Nuk ka asnjë dyshim, nëse gjërat shkojnë ashtu si po shkojnë, në Kosovë 100 % do të kemi një luftë të re. Për këtë, një herë tjetër! **(Fund)**

# Ministri Gashi viziton këngëtaren Nexhmije Pagarusha në spital

**Prishtinë, 11 korrik (ER)** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të mërkurën në spital, bilbilin e gjuhës shqipe, këngëtaren Nexhmije Pagarusha, pas aksidentit të pësuar në banesën e saj. Ministri Gashi u informua për së afërmi për gjendjen shëndetësore të këngëtares së madhe Pagarusha dhe u shpreh i lumtur që gjendja e saj është e mirë dhe që, fatmirësisht, nuk ka pësuar ndonjë lëndim më të rëndë pas aksidentit të mbrëmshëm. "E vizitova krenarinë kombëtare, bilbilin e këngës shqipe, Nexhmije Pagarusha. U interesova personalisht për gjendjen e saj shëndetësore dhe ndihem jashtëzakonisht i lumtur e i gëzuar që ajo është në gjendje të mirë dhe nuk ka pësuar ndonjë lëndim serioz. I dëshiroj shërim sa më të shpejtë këngëtares dhe dua t'i falënderoj tërë ata që janë përkujdesur për shëndetin e saj, stafin mjekësor dhe studentët që kanë ndërhyrë për ta ndihmuar këngëtaren tonë të madhe", u shpreh ministri Gashi.
Ministri i ka ofruar këngëtares Pagarusha mbështetjen e plotë të MKRS-së për çfarëdo që është e nevojshme për këngëtaren.



# PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (7)



Hajdin ABAZI

## IV. PRAKTIKA E TASHME E REKOMANDIMEVE ËSHTË JOKORREKTE

Një problem tjetër serioz lidhet me atë që është bërë shumë popullore - me "rekomandimet". Thuaja nuk ka punim studimor, të të gjitha niveleve, që nuk përmban, krejt në fund, rekomandimet. A është e mirë kjo? Një përgjigje e qëndrueshme kërkon një shtjellim më pak afër, gjë që do të bëhet në vazhdim.
Pyetjes se a duhet të ketë rekomandime apo jo, mund t'i jepet përgjigje: po, por vetëm atëherë kur ato janë vërtet të nevojshme. E pikërisht këtu edhe shfaqet problemi: kur duhet të ketë rekomandime?
Për të arritur deri te kjo përgjigje duhet shqyrtuar më parë se prej nga duhet të rrjedhin, të burojnë rekomandimet, sepse pa e pasur këtë të qartë - ato do të mbeten ashtu sikurse janë në të shumtën e rasteve: "gjymtyrë" të amputuara, domethënë shtojca që i bashkëngjiten disi artificialisht.

### 1. Rekomandimet që nuk janë rrjedhim i studimit

Shumica e punimeve universitare përmbajnë "rekomandime". Shpesh atyre u kushtohet vëmendje shumë e madhe dhe paraqiten me pompozitet, thua se i tërë kontributi studimor qëndron pikërisht te rekomandimet.
Po të lexohen të shkëputura rekomandimet, duken mjaft të qëlluara edhe për një njohës superior të fushës që i përket studimi. Madje, duhet pranuar, shpesh duken shumë të pjekura. Dhe, afërmendsh, edhe krejt të duhura.
Atëherë, ku qëndron problemi?
Problemi mund të hetohet vetëm po qe se lexohet punimi, po qe se lexohet me vëmendje, u mor vesh. Kur të mbërrihet në fund të leximit, "rekomandimet" vijnë si befasi. Si një shtojcë, e bashkëngjitur si me zor. Sepse rekomandimet nuk rrjedhin nga studimi, nuk janë rezultat i tij.
Rekomandimet do të ishin rrjedhë logjike nga punimi sikur në të të ishte bërë ndonjë shqyrtim. Po, po të kishte qasje kritike dhe, krejt në fund, si përplotësim do të ishte e natyrshme të jepeshin rekomandime. Një rrjedhim i këtillë ngjanë rrallë, zakonisht si përjashtim.
Duke lexuar punimet, sidomos ato në shumicë që dominohen nga qasja përshkruese, lexuesi i vëmendshëm do të pyeste, prej nga, vallë, janë nxjerrë rekomandimet? Përgjigjja logjike do të ishte - jo nga studimi, jo nga mënyra se si është bërë shtjellimi.

### 2. Rekomandimet si përgjigje për çështjet që nuk janë ngritur

Nëse jo nga shtjellimi i punimit, atëherë praj nga vijnë rekomandimet?
Përgjigjja më e zakonshme është se rekomandimet kanë të bëjnë me praktika të ndryshme, me probleme të njohura, me sfida, të meta, karaktere negative, keqpërdorime e patologji të ndryshme.
Pa fije dyshimi, duhet pranuar, kjo është e vërtetë.
Me një përgjigje të tillë do të pajtohej çdo njohës i realitetit shoqëror, por jo edhe një lexues i punimit që i parashtron rekomandimet.
Dhe pikërisht këtu ka një defekt të madh: kjo praktikë e keqe as që zihet në gojë gjëkundi në punim. E pra, aspektet negative, të cilave synohet t'u jepet zgjidhje ose të ndalohen, apo minimizohen ose të eliminohen përmes rekomandimeve - do të duhej të kishin qenë të inkorporuara në punim. Po të ishte kështu, atëherë rekomandimet do të vinin të natyrshme.
Në mënyrën e stisjes së rekomandimeve, ashtu sikurse bëhet në shumë raste, ato janë përgjigje ose propozimzgjidhje për probleme e çështje të cilat nuk janë ngritur në punim, zakonisht as që janë shqyrtuar, rrallë ndonjëherë vetëm përmenden përciptazi.

### 3. Një punim mund të ketë karakter shkencor edhe pa rekomandime

Stisja e rekomandimeve prej një burimi që nuk ndodhet në punim, është praktikë jo e mirë. Kjo praktikë duhet dhe është e mundshme të tejkalohet. Duke lexuar punime të shumta krijohet perceptimi se rekomandimet konsiderohen të domosdoshme, të cilat i vulosin karakterin shkencor një punimi. Në fakt, nuk është aspak kështu. Një punim mund të jetë shkencor me ose edhe pa rekomandime.
Duhet të ngulitet mirë në mendjen e secilit studiues, së pari, se nëse duhet të ketë rekomandimet në një punim atëherë ato duhet të rrjedhin ekskluzivisht prej studimit. Nga mangësitë, të metat, gabimet, formalitetet, keqpërdorimet etj. që theksohen në punim do të duhej të rridhnin rekomandimet. Vetëm po qe se bëhen kështu, atëherë po, do të kishte logjikë të shkruhen rekomandime, për të treguar se si do të mund të korrektoheshin apo eliminoheshin dukuritë negative të shqyrtuara gjatë studimit e që janë pengesë, frenues ose dëmtues të objektit të studimit.
Po ashtu, duhet të ngulitet mirë në mendje të studiuesit, së dyti, se jo çdoherë dhe çdo punim ka nevojë për rekomandime. Nëse nuk rrjedhin nga shqyrtimi i bërë në punim është më mirë të mos ketë fare rekomandime. Një studim mund të jetë fare mirë shkencor edhe pa rekomandime.

### 4. Dy lloje rekomandimesh

Sa kam vënë re, ka një paqartësi konceptuale të përhapur gjerësisht rreth asaj se çka janë rekomandimet.
"Rekomandimet" janë sugjerime, këshilla apo udhëzime se si duhet bërë ndonjë gjë ose se duhet vepruar në të ardhmen. Rekomandimet mund të luajnë ndonjë rol vetëm po qe se janë rezultat i studimit; përndryshe - ato realisht janë të tepërta dhe të panevojshme. "Rekomandimet" mund të jenë dy llojesh për nga natyra.
Njëri lloj i rekomandimeve, e që do të duhej të ishte më i zakonshëm, lidhet drejtpërdrejt me punimin. Studimet, edhe pse pretendojnë, zakonisht nuk janë shteruese. Nga një studim i mirëfilltë mund të hetohen disa aspekte të cilat nuk ka mundur t'i mbulojë studimi qoftë për shkak të natyrës së studimit, qoftë për shkak të hapësirës. Aspektet e hetuara, por që nuk janë shtjelluar në studim e që janë ose mund të jenë me rëndësi, autori i nënvizon ato dhe (në "rekomandime") sugjeron ose tërheq vëmendjen e kolegëve, të atyre që do të donin të studionin të njëjtën temë t'i kenë parasysh edhe aspektet e potencuara (por të pashtjelluara). Me fjalë të tjera, studiuesi u tregon kolegëve të vet që kur të projektojnë ndonjë studim t'i kenë parasysh aspektet që nuk janë shtjelluar dhe që mund të jenë të rëndësishme. Rekomandime të këtilla, për fat të keq, gjenden shumë rrallë. Unë kam parë shumë pak.
Lloji tjetër i rekomandimeve lidhet me aspektet praktike të objektit të studimit. Ndonëse, sikurse u tha më sipër, zakonisht nuk burojnë nga vetë studimi, rekomandimet që janë bërë praktikë dominuese deri më sot janë udhëzime për mekanizma të ndryshëm institucionalë, shoqërorë e shtetërorë, se si duhet të veprojnë ato. Sigurisht se mund të bëhen rekomandime edhe të kësaj natyre, por rekomandimet e këtilla do të kishin kuptim dhe do të ishin të natyrshme, në funksion të karakterit të studimit të punimit, vetëm po qe se ato janë rrjedhim nga shqyrtimi i atyre çështjeve të cilave u referohen rekomandimet. Madje rekomandimet e kësaj natyre do të duhej të ishin udhëzime se si gjetjet e studimit do të mund të zbatoheshin.

### 5. Njëri lloj i rekomandimeve ose tjetri ose të kombinuara

Duke mbajtur parasysh faktin se rekomandimet janë të dy llojeve, ashtu sikurse u tha më sipër, besoj se mund të shprehen disa mendime se si mund të arrihet më mirë deri te rekomandimet, dhe kështu të iniciohet një praktikë e re, efektive dhe me karakter studimor.
Dua të theksoj se nuk pretendoj të jap ndonjë formulë magjike, sepse nuk ka të tilla që të ofrojnë zgjidhje të mrekullueshme, si me shkopin magjik. Do të mund të jap vetëm disa sugjerime nga ajo që kam mësuar, të cilat, besoj, janë të duhura për të bërë një hap më përpara. Një qartësi më e madhe do të arrihet kur të flas pak më tutje lidhur me hipotezat, por këtu do të parashtroj disa mendime për të dalë nga kjo gjendje.
Sikurse u theksua më sipër, kryesorja është që nëse do të duhet të jepet ndonjë rekomandim ai duhet të burojë, të rrjedhë dhe të vijë nga shqyrtimi i bërë në punim. Nga vetë shqyrtimi rrjedhin, nëse rrjedhin, rekomandimet dhe të cilit lloj do të jenë ato.
Po qe se studimi ka karakter praktik, përkatësisht lidhet me ndonjë mënyrë aplikative, atëherë rekomandimet duhet të tregojnë se si rezultatet e studimit mund të aplikohen. Rekomandimet e këtilla do të jepnin orientime dhe do ta lehtësonin mënyrën e zbatimit apo përdorimit të arritjeve të studimit.
Lloji tjetër i rekomandimeve mund të jetë ajo që lidhet po me studimin. Studiuesi jep rekomandime për studimet e ardhme të së njëjtës fushë. Hetimet që ai ka bërë, ndonjë aspekt që e ka hasur gjatë studimit, por që ka qenë jashtë domenit të tij, ndonjë aspekt që ai nuk ka arritur ta shtjellojë aq sa është dashur dhe se ka materie për t'u studiuar më thellësisht, më gjerësisht dhe më në tërësi, e që do të ishte me interes shkencor të bëhej. Pa fije dyshimi, jo të gjithë studiuesit, por vetëm ata që janë bujarë, kanë zemërgjerësinë për t'u dhënë të tjerëve ide se si do të mund të realizonin ndonjë punim.
Në punime mund të përdoret njëri ose lloji tjetër i rekomandimeve ose, në ndonjë rast specifik, mund edhe të kombinohen po qe se janë në funksion të studimit dhe rrjedhin nga ai. Po ashtu, do të sugjeroja fort të shmanget pozicioni urdhërues i rekomandimeve e të përdoret gjuha këshilluese.

### 6. Kontrollimi dhe kalibrimi i rekomandimeve me studimin

Po si mund të dihet se një rekomandim rrjedhë nga studimi?
Ka shumë mënyra për të kontrolluar një rekomandim, nëse është i duhur apo jo, sidomos nëse buron apo jo nga studimi.
Unë do ta sugjeroja mënyrën më të zakonshme. Pasi të jetë përpiluar një rekomandim, autori duhet ta shtrojë pyetjen: ku referon ky rekomandim? Domethënë në cilin kapitull apo nënkapitull është shtruar një problem apo çështje, që rekomandimi në fjali referon?
Për ta kuptuar qëndrueshmërinë dhe a është i përputhshëm një rekomandim duhet shkuar te kapitulli/nënkapitulli përkatës, aty ku është shtruar e shqyrtuar një problem apo një çështje. Të lexohet se çka është thënë dhe të krahasohet me rekomandimin, a janë të përputhshme apo jo, a është rekomandimi përgjigje apo zgjidhje e duhur për atë që është thënë? Nëse po, atëherë gjithçka është në rregull. Nëse nuk është si duhet, mund të bëhen ndryshime: më e drejtë është të riformulohet rekomandimi që të bëhet i përputhshëm me atë që është parashtruar në studim, dhe kjo është më e lehtë. Natyrisht, mundet edhe në kapitullin/nënkapitullin përkatës të riformulohet problemi apo çështja, por kjo është më e zorshme dhe duhet treguar shumë kujdes që ndryshimi të jetë në përputhje me ato që janë thënë më përpara dhe më pas në studim. Pikërisht për shkak se mund të implikojnë dhe të ndikojnë në rrjedhë të shtjellimit, po qe se ndërhyhet më brenda të tekstit, ato janë më të vështira dhe zakonisht nuk preferohen për shkak të rreziqeve që mund të mbartin.
Një kontroll i këtillë jep mundësi të kalibrimit të rekomandimeve me ato që janë shqyrtuar brenda tekstit të studimit. Duke vepruar kështu, në radhë të parë, do të krijohej një harmoni midis studimit si tërësi, ashtu që çdo gjë të jetë e lidhur dhe e ndërvarur strukturalisht, por edhe përmbajtjesisht. Kjo, po ashtu, do ta bënte konsekuent studimin nga aspekti metodologjik.
**(Vijon)**

**(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vjet lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)**

## Pompeo në Bruksel, takime për Iranin

**Bruksel, 11 korrik** - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, i cili ndodhet në Bruksel, ka planifikuar të zhvillojë takime në periferi të samitit të NATO-s për t'i siguruar aleatët se Irani nuk do t'i ndalë dot furnizimet me naftë që kalojnë përmes ngushticës së Hormuzit. Më parë, gjatë të mërkurës, Pompeo ishte në Emiratet e Bashkuara Arabe ku siguroi autoritetet atje se ShBA-ja është e vendosur ta bindë udhëheqjen iraniane se sjellja e keqe e saj nuk do të shpërblehet.
Javën e kaluar presidenti iranian Hassan Rouhani kërcënoi ta ndërpresë rrjedhën ndërkombëtare të naftës nëpërmjet ngushticës së Hormuzit, nëse Shtetet e Bashkuara vazhdojnë përpjekjet që vendet e ndryshme të mos blejnë më naftë iraniane.
Pompeo ka theksuar angazhimin amerikan për të siguruar që korridoret e lëvizjes së anijeve të mbeten të hapura.
Departamenti amerikan i Shtetit tha se diplomatët amerikanë kanë zhvilluar bisedime kohët e fundit në Arabinë Saudite, me qëllim për të "ruajtur një treg nafte të furnizuar mirë, për ta mbrojtur nga paqëndrueshmëria".



# Trumpi kritikon ashpër Gjermaninë

Presidenti amerikan Donald Trump e nisi ditën e mërkurë me kritika të ashpra dhe publike ndaj Gjermanisë, në takimin e nivelit të lartë të NATO-s që u hap në Bruksel, që i drejtoheshin mbështetjes së Gjermanisë ndaj një marrëveshjeje me Rusinë për gazin e Detit Baltik



**Bruksel, 11 korrik** - Presidenti amerikan Donald Trump kritikoi publikisht dhe ashpër Gjermaninë në takimin e nivelit të lartë të NATO-s në Bruksel. Kritikat e Trumpit shënuan fillimin e një dite të tensionuar takimesh me udhëheqësit e aleancës ushtarake. Presidenti amerikan është përplasur me aleatët e NATO-s për çështjen e shpenzimeve të tyre ushtarake, që ai i quan të pamjaftueshme.
Presidenti amerikan Donald Trump e nisi ditën e mërkurë në Bruksel me kritika të ashpra dhe publike ndaj Gjermanisë, në takimin e nivelit të lartë të NATO-s që u hap në Bruksel.
Kritikat e Trumpit i drejtoheshin mbështetjes së Gjermanisë ndaj një marrëveshjeje me Rusinë për gazin e Detit Baltik. "Po ta shohësh me kujdes, Gjermania është bërë peng i Rusisë, duke mbyllur uzinat e qymyrgurit dhe reaktorët bërthamorë. Fakti që ajo po merr aq shumë naftë dhe gaz nga Rusia mendoj se është diçka që NATO-ja duhet ta shikojë me kujdes. Mendoj se është diçka shumë e pavend. Unë dhe ju jemi dakord që është e pavend. Nuk e di se çfarë mund të bëhet tani, por sigurisht nuk duket se ka kuptim që ata t'i paguajnë Rusisë miliarda dollarë dhe tani ne duhet t'i mbrojmë nga Rusia", tha presidenti Trump.
Kancelarja Merkel më vonë iu përgjigj kritikave të Trumpit, duke thënë se Gjermania, një nga kontribuuesit më të mëdhenj me trupa në misionet e NATO-s, është e lirë nga kontrolli rus që nga rënia e murit të Berlinit. Ajo kujtoi rininë e saj në Gjermaninë Lindore të dominuar nga sovjetikët dhe tha se ishte shumë e lumtur që sot vendi është i bashkuar në liri. "Mund të themi se për shkak të kësaj ne mund t'i hartojmë politikat tona të pavarura dhe t'i marrim vendimet tona të pavarura", tha ajo.
Ndërkohë, gjatë dhe pas takimit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s reagoi ndaj kritikave, duke theksuar se anëtarët e NATO-s kanë qenë në gjendje të punojnë së bashku, pavarësisht prej dallimeve mes tyre. "Ne jemi më të fortë së bashku sesa të ndarë. NATO-ja duhet të jetë e fortë për t'i mbrojtur aleatët. Ne do ta forcojmë mbrojtjen kolektive, që do të thotë se trupat e ShBA-së, trupat kanadeze, trupat evropiane do të bëjnë më shumë së bashku", tha ai.
Stoltenbergu u tha gazetarëve se presidenti Trump kishte përdorur një "gjuhë shumë të drejtpërdrejtë", por të gjithë aleatët e NATO-s pajtohen se kostoja e shpenzimeve të mbrojtjes duhet të bjerë mbi të gjithë.
Shkëmbimi dramatik i fjalëve midis presidentit Trump dhe Stoltenbergut vendosi tonin për atë që pritej të ishte një ditë e tensionuar takimesh me udhëheqësit e aleancës ushtarake. Takimi i nivelit të lartë vjen në një klimë marrëdhëniesh të tensionuara midis presidentit amerikan dhe aleatëve më të afërt të Shteteve të Bashkuara.
Trumpi është përplasur me aleatët e NATO-s për çështjen e shpenzimeve të tyre ushtarake. "Shtetet e Bashkuara po paguajnë shumë ndërsa vendet e tjera nuk paguajnë sa duhet", u ankua Trumpi. "Kjo po ndodh prej dekadash, është e shpërpjesëtuar dhe jo e drejtë ndaj taksapaguesve amerikanë", tha ai.
Presidenti Trump i njohu meritën vetes për fillimin e një prirjeje të re midis anëtarëve të NATO-s, ndryshe nga e kaluara, kur shpenzimet e mbrojtjes kishin ardhur duke rënë.

## Greqia dëbon dy diplomatë rusë

**Athinë, 11 korrik** - Greqia urdhëroi dëbimin e dy diplomatëve rusë dhe ua ndaloi hyrjen dy të tjerëve, nën dyshimet se kanë rrezikuar sigurinë kombëtare.
Qeveria greke tha se zyrtarët rusë kanë synuar të sigurojnë dhe të shpërndajnë informacione të ndjeshme.
Zëdhënësi i Qeverisë greke, Dimitris Tzanakopoulos, tha se Athina nuk do të tolerojë asnjë sjellje që shkel ligjin ndërkombëtar.
Gazeta greke "Kathimerini" tha se Athina ka urdhëruar dëbimin e diplomatëve rusë pas përpjekjeve të perceptuara të tyre për ta dëmtuar marrëveshjen që Greqia ka arritur me Maqedoninë, muajin e kaluar, për zgjidhjen e kontestit të emrit të ish-Republikës Jugosllave.
Marrëveshja pritet ta hapë rrugën për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.
Rusia, e cila është kundër zgjerimit të aleancës ushtarake perëndimore, tha se do t'i përgjigjet dëbimit të diplomatëve të saj nga Greqia.



Fjalë e mbajtur në konferencën shkencore "40 vjet veprimtari shkencore e krijuese të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha"

# Në tërësinë e shkrimeve të Sabile Keqmezi-Bashës dominon stili i të shkruarit historiografik

**Prof. dr. Ibrahim GASHI**

*Të nderuar të pranishëm,*
*E respektuar kolege Keçmezi-Basha,*

E konsideroj nder të posaçëm që jam pjesë e folësve të sotëm për një krijimtari kaq të begat të studiueses sonë, tashmë të mirënjohur nga një audiencë e gjerë shkencore dhe artistike, dr. Sabile Keçmezi-Basha.

Si pedagog tash e një kohë të gjatë në Departamentin e Historisë të UP-së më ka rënë të analizoj nga afër, ndonjëherë edhe si recensent, krijimtarinë shkencore nga fusha e studimeve të historisë bashkëkohore shqiptare të studiueses Sabile Keçmezi-Basha. E kam thënë edhe në raste të tjera, por dua të ripohoj, besoj më kompetencë, se në tërësinë e shkrimeve të saj dominon stili i të shkruarit historiografik, i shkollës tradicionale të mbështetur vetëm në dëshmi arkivore dhe burime primare. Opusi i veprave historiografike, veçmas ato mbi lëvizjen ilegale shqiptare të pas Luftës së Dytë Botërore, janë një arkiv në vete të cilat përdoren gjerësisht nga studiuesit si burime primare. Nuk kemi shënime vebometrike, por sigurisht veprat e dr. Sabile Keçmezit janë cituar qindra mijëra herë në punimet e studiuesve të historisë bashkëkohore, shqiptarë dhe të huaj.

Me studimet e saj, veçmas pas rënies së komunizmit dhe heqjes së censurës, dr. Sabile Keçmezi-Basha, më shumë se secili nga ne, ka kryer një mision të shenjtë sa shkencor, po aq edhe kombëtar, duke nxjerrë nga përbaltja ideologjike dhe politike figura të ndritshme të lëvizjes sonë kombëtare të cilat, për më shumë se dyzet vjet, ishin stigmatizuar si armiq të regjimit dhe ishin hequr nga historia ose, për më keq, ishin futur në histori, por në mënyrë të shtrembëruar. Pasioni i vërtetë i studiueses Keçmezi, për të hulumtuar në dokumente arkivore dhe për të nxjerrë nga aktakuza, procesverbale dhe vendime gjyqësore veprimtarinë atdhetare të shumë patriotëve tanë, për çka edhe u dënuan, na ka sjellë tek ne përmasën e vërtetë të lëvizjes ilegale për liri dhe bashkim kombëtar, që filloi më të mbaruar Lufta e Dytë Botërore dhe që përfundoi me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



*Të nderuar të pranishëm, e nderuar kolege Sabile,*

Janë të rralla rastet e tilla promocionale, madje gati unike ndër ne, kur një panel kaq i zgjeruar i folësve do të arrijë të shpalosë fare pak nga një opus kaq i gjerë i një krijueseje të madhe që duket moshën ta ketë 40-vjeçare e krijimtarinë 65-vjeçare, edhe pse është e kundërta. Janë për admirim personalitetet e shkencës që janë kaq prodhues dhe që i japin brezit të tyre, sidomos brezave të ardhshëm, kaq shumë vlera diturore, ndërsa veten e fusin në panteonin e dijetarëve të kombit. Kur fliste për mësuesin shkencëtari i madh Albert Ajnshtajni theksonte: "Arti suprem i mësuesit është ta zgjojë gëzimin, shprehinë krijuese dhe diturinë".

Dr. Sabile Keçmezi-Basha për shumë historianë dhe poetë të ri, sikurse një mësuese e vërtetë, ka ngjallur, gëzim, shprehi krijuese dhe dituri shkencore, duke e bërë shumë më të dashur profesionin që ata kishin zgjedhur. Personaliteti i saj krijues dhe njerëzor ishte dhe vazhdon të jetë inspirues për secilin që synon t'i arrijë majat. Madhështia e tërë kësaj qëndron se edhe tani kur ajo ka një moshë që nuk duket fare, veçse si numër, vazhdon të jetë po aq inspiruese. Aktorja e madhe Sophia Loren me rastin e pensionimit të saj theksonte: "Ekziston një burim i të qenurit përherë i ri: është mendja juaj, talentet tuaja, kreativiteti që ju sjellin në jetën tuaj dhe jetën e njerëzve që doni. Kur mësoni të prekni këtë burim, do ta keni mundur me të vërtetë moshën".

Pa dyshim, jo për koincidencë, kjo thënie i shkon protagonistes sonë për të cilën po flasim këtu, por jo secilit njeri. Vetëm pas një krijimtarie të pasur jetësore njeriu mund të rrezatojë kreativitet, mendje të ndritur dhe talent edhe në moshën e pensionimit. Më ka rënë të lexoj një thënie të Arthur E. Morgan se: "Përgatitja për moshën e vjetër duhet të fillojë jo më vonë se në adoleshencë. Një jetë e cila është bosh e pa qëllim deri në 65 vjeç nuk do të bëhet e papritur e mbushur në pension".

*E nderuar kolege Keçmezi-Basha,*

Ne që ju kemi njohur përmes veprave si studiuese dhe përmes bashkëpunimit si studiuese dhe si njeri, e konsiderojmë veten me fat dhe krenarë që ndajmë të njëjtin profesion. Dua ta potencoj pjesën humane të personalitetit Tuaj, sipas perceptimit tim. Ju gjithmonë keni reflektuar respekt, korrektesë dhe elokuencë të madhe në komunikim dhe në sjellje me të tjerët. Arma më e fortë në pjesën njerëzore të personalitetit tuaj duket të ketë qenë sinqeriteti dhe modestia, ndërsa në pjesën profesionale puna e madhe hulumtuese dhe pedanteria e të shkruarit shkencor dhe artistik. Shumë nga ne që kemi pasur fatin të lëvizim në institute dhe universitete të botës perëndimore, kur ndodhemi përpara krijimtarisë suaj, ndihemi shumë mirë, sepse një kolege jona ka arritur të këtë një opus shkencor dhe jo vetëm të krahasueshëm me studiuesit dhe shkencëtarët perëndimorë, ani pse ka vepruar dhe krijuar në një ambient pakrahasimisht më të trazuar.

Nisur nga vlerësimet që u dhanë, konsideroj se Instituti i Historisë "Ali Hadri" ka pasur dhe ka njerëz të aftë dhe studiues të zotë, por dr. Sabile Keçmezi-Basha është dhe do të mbetet një nga simbolet e krenarisë institucionale dhe akademike të tij.

Në fund dua t'ju uroj të keni një kapitull të ri relaksues përpara, ku ju do të keni shëndet të mirë dhe kohë të pakufizuar për ta shijuar jetën tuaj dhe për të krijuar atë që mendoni se duhet ta bëni.

# Certifikohet për herë të parë puna vullnetare në Kosovë

**Prishtinë, 11 korrik (ER)** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me UNICEF-in, kanë certifikuar 30 "Mentorët vullnetarë rinorë" bazuar në Udhëzimin Administrativ për Punë Vullnetare 01/2016. Me këtë rast ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, ka thënë se sot është një ditë e rëndësishme për të gjithë të rinjtë e Kosovës, veçanërisht për të rinjtë të cilët për herë të parë certifikohen si punëtorë vullnetarë. Ai ka bërë me dije se ky proces rrjedh nga ligji për fuqizimin e rinisë, përkatësisht nga udhëzimi administrativ për vullnetarë. "Kur të rinjtë aplikojnë për punë, u kërkohet përvoja e punës. Prandaj, është mundësi e mirë ta shfrytëzoni platformën e ministrisë. Certifikata ua njeh një vit përvojë pune. Është një përmbushje e synimeve tona që të gjithë të rinjtë e Kosovës të mos kenë pengesa gjatë aplikimit për punësim. Besoj se ky proces do të jetë inkurajues për të gjithë të rinjtë e Republikës së Kosovës që të bëjnë punë vullnetare në komunitet në të gjitha komunat, nëpër organizata, nëpër institucione dhe të jenë pjesë e të gjitha përpjekjeve për ta rregulluar çështjen e të rinjve, shqetësimet dhe problemet e tyre", ka thënë Gashi.



Ai ka vlerësuar edhe bashkëpunimin e ngushtë me UNICEF-in si një partner i rëndësishëm i MKRS-së, duke theksuar se bashkërisht janë të vendosur ta shtyjnë përpara promovimin e konceptit të vullnetarizmit rinor me qëllim të motivimit të të rinjve për shërbim në komunitet në të mirë të shoqërisë. "Sot falë punës së përbashkët dhe mbështetjes së madhe të kolegëve tanë në UNICEF po certifikojmë 30 të rinjtë për mentor vullnetarë. Ky certifikim është me rëndësi të madhe dhe shtytës që të monitorohet i tërë procesi i punës vullnetare për të gjithë ofruesit e punës vullnetare dhe vullnetarëve të angazhuar", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq shefi i Zyrës së UNICEF-it, Brandao Co, është shprehur i kënaqur për bashkëpunimin me MKRS-në dhe ministrin Gashi. "Puna vullnetare është një punë që i ndihmon komunitetit. E di që ka shumë vullnetarë në Kosovë që shpëtojnë jetë dhe dëshirojnë t'ju ndihmojnë të tjerëve. Me punë vullnetare ata bëjnë edhe përvojë pune. Jemi të kënaqur që puna vullnetare është globalisht e njohur", ka thënë Co.

E rrallë

# Një hundë artificiale që nuhat atmosferën në punë



Një politeknik nga Milano ka krijuar një hundë elektronike që monitoron cilësinë e ajrit në ambientet e punës. Kjo pajisje dërgon sinjale alarmi kur ndotja kalon nivelin e lejuar, duke i mundësuar përdoruesit t'i veshë sistemet e duhura të mbrojtjes ose të largohet në rast rreziku për shëndetin.

FOTO E DITES




Artisti francez Abraham Poincheval vesh një uniformë të blinduar. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Kapet krokodili gjigant në Australi, jeton prej 60 vjetëve



Autoritetet në Australi kanë arritur ta kapin krokodilin gjigant 4.7 metra të gjatë, i cili peshon rreth 600 kilogramë. Krokodili që besohet të ketë mbi 60 vjet është kapur në ujërat në afërsi të një porti ku ndalen anijet në liqenin Kathryn. Ai konsiderohet si krokodili më i gjatë që ndonjëherë është kapur në këtë zonë.

## BARSOLETA E DITËS



**Çifti i ri i sapomartuar vjen në hotel.**
**- "Ju lutem, dhomën më të mirë për tri netët e ardhshme", thotë burri.**
**Portieri i pëshpërit gruas së re:**
**- "Qenkeni me fat, zonjushë. Zakonisht ky e merr dhomën vetëm për ca orë".**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed







Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Një tërheqje fizike mund të sjellë probleme serioze në lidhjen tuaj në të ardhmen. Përpiquni t'i menaxhoni emocionet.



**DEMI**
Jeni bërë gati për disa ditë pushimi jashtë vendit tuaj. Koha po ju kalon shumë shpejt duke u marrë me përgatitjet e udhëtimit.



**BINJAKËT**
Jeni në humor që në orët e para të mëngjesit dhe dita duket se do ta pasqyrojë këtë energji tuajën. Në mbrëmje, mjaft të qeshur me miqtë.



**GAFORRJA**
Sot do të vazhdoni të vetëm një projekt që e kishit nisur me mjaft bashkëpunëtorë. Rrugës së realizimit të këtij projekti patë që shumë prej tyre nuk ju mbështesnin.



**LUANI**
Gjatë pasdites do të jeni kritikë dhe në humor të keq me personat që ju rrethojnë. Shkak do të jetë një situatë disi shqetësuese që nuk ju ka pëlqyer.



**VIRGJËRESHA**
Shumë gjurmë të së shkuarës janë pengesë për të tashmen tuaj. Duhet të jeni ju të parët që të qartësoheni me veten.



**PESHORJA**
Edhe pse doni të bëni shumë gjëra të këndshme, do të shikoni që e keni të pamundur me personat të cilët keni zgjedhur të punoni.



**AKREPI**
Me personat e zemrës do të keni një marrëdhënie shumë të mirë falë komunikimit tuaj edhe në ato çaste kur keni menduar ndryshe.



**SHIGJETARI**
Sot do të jetë ditë plot entuziazëm dhe argëtim pa fund. Po shijoni bashkë me familjen çdo çast të saj dhe java që vjen do të fillojë mbarë.



**BRICJAPI**
Logjika dhe intuita do të ecin bashkë sot duke ju dhënë zgjidhje të përkryer për çdo problem që mund t'ju dalë gjatë ditës.



**UJORI**
Sot, edhe pse nuk do të jeni shumë të komunikueshëm, nuk do të thotë se do të qëndroni vetëm. Miqtë e njohin këtë defekt tuajin në ditë të caktuara.



**PESHQIT**
Disa probleme familjare do të zgjojnë tek ju dyshime të së shkuarës. Keni një moment ftohje me partnerin që do ta rikuperoni shumë shpejt.

# 50 Cent ia blen vetes një dhuratë super të shtrenjtë për ditëlindje



50 Cent ia dhuroi vetes një "Rolls-Royse" mat të zi për ditëlindjen e 43-të, shkruan "Page Six". Reperi bashkë me makinën e re u nis drejt festës së tij të mbajtur në "Pier 115 Bar & Grill" në Edgewater. Bashkë me të ishin edhe DJ SpinKing dhe DJ Ammo.

# Ku shkoi Drake i veshur kaq bukur?




Reperi Drake dukej aq bukur derisa arriti në klubin Annabel për një natë me miqtë në Londër. Reperi 31-vjeçar kishte të veshur një kostum gri të kombinuar me një bluzë të zezë dhe ishte i shoqëruar me një grup femrash. Drake kohët e fundit po shijon suksesin e albumit prej 29 këngësh.




# Pas pushimeve të gjata, Kourtney rikthehet në shtëpi

Kourtney Kardashian është kthyer në shtëpinë e saj në California pas pushimeve të gjata në Itali. 39-vjeçarja është parë me djalin tetëvjeçar, Mason, për një drekë në Katsuya në Los Angeles. Kourtney ka qenë në Itali me të dashurin e saj dhe tre fëmijët.

# Pas fejesës, ky është vendi ku shkuan Justin dhe Hailey



Justin Bieberi dhe Hailey Baldwin po e shijojnë fejesën e tyre. Çifti është parë të martën në Nju Jork. Ata u kapën bashkë në aeroport derisa u nisën drejt apartamentit të modelueses. Hailey edhe këtë herë ekspozoi unazën gjigante të fejesës derisa ishte duke mbajtur valixhen. Çifti u fejua gjatë pushimeve në Bahamas javën e kaluar.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | CSKA SOFIA - FC RIGA | 1 | LAHTI - HAFNARFJORDUR | 1 | ANORTHOSIS - LACI | 3+ |

# Francë-Kroaci, finalja e Botërorit

**Finalja e këtij Botërori do të zhvillohet më 15 korrik në mes Francës dhe Kroacisë. Kjo e fundit bëri historinë duke u kualifikuar për herë të parë në një finale të Kupës së Botës**

MOSKË, 11 KORRIK - Kroacia është në finale pas një tjetër 120 minutëshi të luajtur në "Luzhniki Stadium". Anglia do të kthehet në shtëpi pa trofeun dhe ballkanasit do të luftojnë për Kupën e Botës me Francën. Anglia bëri një nisje të përsosur duke gjetur golin e avantazhit që në minutën e 5-të me Trippier. Mbrojtësi i djathtë anglez lëshon një goditje fantastike nga ecja duke realizuar një gol ëndrrash në gjysmëfinale. Kroacia nuk reagon ndaj Anglisë që merr zemër dhe mund të kishte dyfishuar rezultatin me anë të Harry Kane apo Jesse Lingard. Prapavija angleze ishte e kujdesshme dhe e pakalueshme gjatë pjesës së parë, por pas pushimit situata ndryshon në mënyrë të pakuptimtë. Befasisht kroatët ishim ata që kontrolluan lojën dhe krijuan rastet për të shënuar dhe Ivan Perisiq e barazoi rezultatin në minutën e 68-të. Me rezultatin 1-1 këto dy kombëtare e mbyllën kohën e rregullt, kurse në minutat shtesë kroatët dominuan dhe pas një pasimi të Perisiqit, Mario Mandzukiq shënoi golin e fitores dhe të kualifikimit 2-1.



# Short i pamëshirshëm për Sigal Prishtinën në Ligën e Kampionëve



PRISHTINË, 11 KORRIK - KB Sigal Prishtina ka mësuar kundërshtarin në Ligën e Kampionëve në basketboll. Shorti ka qenë i pamëshirshëm për skuadrën më të trofeshme në Kosovë pasi përballë saj ka sjellë skuadrën holandeze Donar Gronigen. Prishtina ndaj kësaj skuadre do të luajë dy ndeshje me sistem vajtje-ardhje në rrethin e parë kualifikues. Shtatë herë kampion i Holandës, tri herë rresht në tre sezonet e fundit, si dhe gjashtë herë fitues i Kupës shtetërore, Donar Groningeni është skuadër dominuese në Holandë gjatë viteve të fundit dhe konsiderohet kundërshtar shumë i vështirë për kryeqytetasit.
Ndeshjen e parë kundër Groningenit, Prishtina do ta luajë si vendëse në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve më 20 shtator, kurse ndeshjen e kthimit pas dy ditësh në Holandë. Në rast të kualifikimit më tutje, Prishtina në rrethin e dytë mund të përballet me fituesin e ndeshjes Fribourg - Avtodor, ndërsa suksesi eventual në rrethin e dytë do të vinte përballë skuadrës turke Sakarya nga Turqia në rrethin e tretë kualifikues. Në Ligën e Kampionëve sivjet marrin pjesë 56 klube të ndryshme nga 28 shtete.

# Inspektohen punimet në stadiumin 'Zahir Pajaziti'

PODUJEVË, 11 KORRIK - Kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, dhe drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ibër Alaj, vizituan të mërkurën stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, ku janë duke u realizuar punimet për ndërtimin e tribunave dhe të infrastrukturës përcjellëse. Kryetari Veliu ka shprehur optimizëm se punët në kompletimin e infrastrukturës përcjellëse në stadium, tribunat dhe zhveshtoret, do të përfundojnë deri në fillimin e kampionatit të ri futbollistik. "Pas ndërtimit të fushës me bari sintetik, në stadium u krijuan kushtet për lojëra cilësore, kurse me finalizimin e ndërtimit të tribunave shikuesve u ofrohet komoditet, që në sezonin e ardhshëm futbollistik t'i përcjellin ndeshjet e FC 'Llapi' në këtë stadium modern", ka thënë kryetari Veliu.
Ndërtimi i tribunave dhe infrastrukturës përcjellëse në Stadiumin "Zahir Pajaziti" është investim i përbashkët i MKRS-së, Komunës së Podujevës dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.





## Prishtina merr rezultat pozitiv në Luksemburg

PRISHTINË, 11 KORRIK - Fitusja e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina ka marr rezultat pozitiv në ndeshjen e Evropa Ligës ndaj Folas (0-0). Në ndeshjen e raundit të parë eliminator të Ligës së Evropës klubi nga kryeqyteti i Kosovës pa gola dhe ky rezultat i konvenon Prishtinës për ndeshjen kthyese që zhvillohet në Kosovë. Ndeshja kthyese zhvillohet më 18 korrik.

## Ja 10 zëvendësuesit e mundshëm të Ronaldos në Real

**Madrid, 11 korrik** - Cristiano Ronaldo pas nëntë vjetësh të suksesshme me Real Madridin vendosi të largohet për ta vazhduar karrierën në Itali me Juventusin. Drejtuesit e Realit po mendojnë për zëvendësuesin e portugezit. Ndërsa "Goal.com" ka publikuar dhjetë lojtarët që mund të jenë pasardhës të portugezit në "Santiago Bernabeu".
Lista e dhjetë futbollistëve: Neymar, Kylian Mbappe, Eden Hazard, Robert Lewandowski, Mauro Icardi, Harry Kane, Mohamed Salah, Paulo Dybala, Sergej Milinkovic-Saviq, Christian Pulisiq.



# Pele: Kampionët si Ronaldo nuk lodhen kurrë me sfida të reja



**Torino, 11 korrik** - Vendimi i Cristiano Ronaldos për t'i dhënë fund përvojës 9-vjeçare te Real Madridi dhe nënshkruar me Juventusin është veprim i duhur, sipas legjendës së futbollit, brazilianit Pele. Ronaldo u pajtua për një kontratë katërvjeçare me kampionët e Serisë A për ta kompletuar një transferim prej 100 milionë eurosh të martën.
